



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim i Terminologjisë (B-A)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 seminare.

Viti / Semestri: Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuri mbi terminologjinë e specializuar në fushën e politikës, drejtësisë dhe diplomacisë nëpërmjet teksteve të medias. Të zhvillojë aftësitë e tyre për të kuptuar dhe interpretuar mesazhe tekstuale dhe nënkuptime të tyre në kontekste të ndryshme gjuhësore dhe kulturore. Të nxisë integrimin e dijeve ndërdisiplinore për zbërthimin dhe përkthimin e saktë të teksteve të specializuara.

Objektivat specifike lëndore :

1. Të njohë studentët me teknikat dhe strategjitë e përkthimit të teksteve politike, juridike dhe diplomatike të stilit mediatik.
2. Të trajtojë në mënyrë teorike dhe praktike aspektet gramatikore, leksikore dhe stilistike të teksteve sipas stilit funksional.
3. Të aftësojë studentët në analizën e semantikës, barazvlefshmërisë dhe tonit të mesazheve për përkthim të saktë dhe kontekstual.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të interpretojnë dhe përkthejnë tekste nga fusha të specializuara (politikë, drejtësi, diplomaci) duke ruajtur saktësinë dhe qëllimin komunikativ.
2. Do të aplikojnë njohuritë e marra nga stilistika, leksikologjia dhe gramatika për të analizuar dhe përkthyer në mënyrë të informuar dhe kritike.
3. Do të zhvillojnë aftësi për të identifikuar tonin, qëllimin dhe audiencën e tekstit dhe për të përshtatur përkthimin sipas kërkesave stilistike dhe funksionale të diskursit mediatik.